


SHTYLLAT E ISLAMIT



Shtyllat e Islamit janë pesë:

1. Dëshmia se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut.
2. Falja e namazit.
3. Dhënia e zekatit (lëmoshës së detyrueshme).
4. Agjërimi i ramazanit.
5. Kryerja e haxhit, për atë që ka mundësi.

Shtyllat e Islamit janë dy llojesh:

- a. Shtylla pa të cilat nuk mund të qëndrojë Islami, ndryshe quhen “shtylla thelbësore”, e që janë:
 1. Të dëshmuarit se nuk meriton të adhurohet askush përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguar i Allahut.
 2. Falja e namazit.
- b. Shtylla pa të cilat nuk mund të plotësohet Islami, ndryshe quhen “shtylla plotësuese”, të cilat janë:
 1. Dhënia e zekatit (lëmoshës së detyrueshme).
 2. Agjërimi i ramazanit.
 3. Kryerja e haxhit, për atë që ka mundësi.

Argumenti

Thënia e të Dërguarit të Allahut, sal-lallahu alejhi ue sel-lem:

“Islami është ndërtnuar mbi pesë: të dëshmuarit se nuk meriton të adhurohet askush përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij, faljen e namazit, dhënien e zekatit, agjërimin e ramazanit dhe haxhillëkun.”
[Muslimi].